208/19
-1-
27.06.2019

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, lidhur me nenin 20.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 40, paragrafi 2, pika (b) dhe nenin 41, paragrafi 2, pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 qershor 2019**, mori këtë:

## VENDIM
## PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME TË SHPENZIMEVE BUXHETORE 2020-2022

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2020/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020-2022.

2 .Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

209/19

-1-

27.06.2019

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 30, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 15, paragrafi 1 i Ligjit nr. 06/l -133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, nenit 40, paragrafi 2, pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 40, paragrafi 2, pika (dh) dhe nenit 41, paragrafi 2, pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 qershor 2019**, mori këtë:

# VENDIM
## PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS NË KATEGORINË E PAGAVE

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shumën prej 71,500.00 € nga programet:

1.1 Zyra e Kryetarit, kodi (16024), shuma........................................................10,000.00 €

1.2 Administrata – Vushtrri, kodi 16324, shuma.................................................7,000.00 €

1.3 Shërbimet kadastrale, kodi 65120, shuma.................................................... 8,000.00 €

1.4 Planifikimi, urbanizmi, inspektimet, kodi 66425, shuma.............................7,000.00 €

1.5 Shërbimet kulturore, kodi 85024, shuma...................................................19,000.00 €

1.6 Arsimi fillor, kodi 93690, shuma..............................................................20,500.00 €

2. Shumat në programet e cekura më lartë, transferohen në programin Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor, kodi 74450 – në shumën totale prej 71,500.00 €

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

## Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
*Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament*

# KËRKESA PËR TRANSFER

**PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i organizatës buxhetore** | **Komuna Vushtrri** | **Kodi** | 644 |
| **Emri i nën-programit** | **Zyra e Kryetarit, Administrata, Shërbimet kadastrale, Planifikimi urban dhe inspeksioni, Shërbimet Kulturore, Arsimi fillor** | **Kodi** | **16024, 16324, 65120, 66425, 85024, 93690** |

**Transferi/Rialokimi**

| Kodi organizativ | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Burimet e Financimit | Kategoria e shpenzimeve | Kodi i projektit | Kategoria shpenzimeve | Aprovimi i tanishëm | Shuma e ndryshimit | Aprovimi i ri | Buxheti Aprovuar/Rishikuar | Totali i shumës së transferuar/rialokuar | % Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 644 | 16024 | 0111 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 187,422.00 | (10,000.00) | 177,422.00 | 187,422.00 | (10,000.00) | -5.34% |
| 644 | 16324 | 0133 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 160,705.00 | (7,000.00) | 153,705.00 | 160,705.00 | (7,000.00) | -4.36% |
| 644 | 65120 | 0610 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 85,963.00 | (8,000.00) | 77,963.00 | 85,963.00 | (8,000.00) | -9.31% |
| 644 | 66425 | 0620 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 65,647.00 | (7,000.00) | 58,647.00 | 65,647.00 | (7,000.00) | -10.66% |
| 644 | 85024 | 0820 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 194,111.00 | (19,000.00) | 175,111.00 | 194,111.00 | (19,000.00) | -9.79% |
| 644 | 93690 | 0912 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 5,129,735.00 | (20,500.00) | 5,109,235.00 | 5,129,735.00 | (20,500.00) | -0.40% |
| 644 | 74450 | 0721 | 10 | Paga dhe meditje | | 11 | 1,415,684.00 | 71,500.00 | 1,487,184.00 | 1,415,684.00 | 71,500.00 | 5.05% |
| | | | | | | | 7,239,267.00 | - | 7,239,267.00 | 7,239,267.00 | - | - |

**PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR**

| | | | |
|---|---|---|---|
| (Shëno Po ose Jo) | | PO | JO |
| | **Transferi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve** | PO | |
| | | PO | |

**PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)**

Kerkojmë lejimin e transferit të mjeteve sipas Vendimit të Kuvendit NR. xxxxxx, për arsye se me rastin e realizimit të kërkesave të punëtorëve (tri paga jubilare dhe paga me rastin e pensionimit) sipas Kontratës Kolektive, Komuna e Vushtrrisë po dëmtohet për shumen e shpenzimeve të gjykatave dhe shumën që po e marrin përmbaruesit.

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

| **Zyrtari kryesor financiar** | **Data** | **Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Abit Abiti** | **8/7/2019** | **Xhafer Tahirii** | **8/7/2019** |

**PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI**

**ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)**

| **KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE** | | **NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*** | |
|---|---|---|---|
| **Drejtor i Buxhetit** | **Data** | **Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*** | **Data** |
| Salvador Elmazi | | | |
| | | **NUMRAT E KD** | |

**Vrejtje:**
***Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorin e shpenzimeve të nën-programit**

01 Nr./Br. 210/19
Nr. i fq./Br. st. -1-
Data/Datum 27.06.2019

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 51, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 54 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 5, paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR.02/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 qershor 2019,** mori këtë:

**VENDIM**
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT ME NR.23/18 I DATËS 25.01.2018**

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-23/18 i datës 25.1.2018, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ashtu që në vend të z. Lutfi Bilalli, nga radhët Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), emërohet znj. Teuta-Aruçi-Shartari, nga i njëjti subjekt politik.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Nasuf Aliu**

____________________

**Kryesues i Kuvendit**

01 Nr. / Br. 211/19
Nr. Fq. / Br. st -1-
Data / Datum 27.06.2019

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **27 qershor 2019,** mori këtë:

**VENDIM**
**PËR APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRRISË 2019-2021**

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe përmirësimi i statusit të këtyre komuniteteve në Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria – Vlada – Government*

Komuna e Vushtrrisë

Opština Vučitrn

# PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

## 2019-2021

*Vushtrri, maj 2019*

**Shkurtesat**

BK - Buxheti i Kosovës

ZKKK - Zyra komunale për komunitete dhe kthim

DA - Drejtoria për Arsim,

DKRS - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DKSHMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim

MAPL - Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjiisë

MTT - Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit

UNHCR - Komisariati i Lartë për Refugjatë

DRC - Këshilli danez për refugjatë

**Përmbajtja**

Hyrje ....................................................................................................X

Metodologjia .............................................................................................. X

Struktura jetësore e kom. rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë ..............X

Arsimimi ......................................................................................................X

Punësimi dhe fuqizimi ekonomik...................................................................X

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale......... ......................................................X

**Hyrje**

Qeveria e Kosovës e ka përgatitur Strategjinë për vitin 2017 - 2021 për integrimin e romëve, ashkalinjëve si dhe planin për implementimin e strategjisë për vitet 2017 - 2021. Strategjia dhe plani i veprimit kanë për qëllim integrimin e komuniteteve rom, ashkali, si dhe përmirësimin e statusit të këtyre komuniteteve.

Strategjia për integrimin e romëve, ashkalinjëve, si dhe plani konkret i veprimit nga niveli qendror janë miratuar në mënyrë të përgjithshme për tërë teritorin e Kosovës e në mënyrë që këto akte të zbatohen në vepër ka qenë i nevojshëm hartimi i planit të veprimit në nivel komunal.

Për përdorimin e lirë të këtyre akteve zyrtare, Zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) në bashkëpunim me drejtoritë komunale, si dhe me përfaqësuesit e OSBE-së dhe organizatave përkatëse vendore dhe ndërkombëtare në formë të grupit punues ka hartuar Planin e Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

Në Planin e Veprimit të Komunës së Vushtrrisë, janë përfshirë të gjitha detyrat konkrete, si dhe masat për integrimin e këtyre komuniteteve.

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve të Komunës së Vushtrrisë, është hartuar në bazë të planit të veprimit me nivelin qendror dhe në vete ngërthen strukturën e tij, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e komuniteteve në komunë, përbën aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në shënimet e marra nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim, si dhe Strategjisë së plotësuar komunale për komunitete dhe kthim.

Kështu është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve lidhur me problemin konkret.

**Plani komunal i veprimit për integrimin e romëve, ashkalinjëve përbën këto fusha të veprimit:**

1. **Arsimi,**
2. **Punësimi dhe fuqizimi ekonomik,**
3. **Shëndeti, mirëqenia sociale dhe ambienti,**
4. **Banimi.**

**Metodologjia**

Qëllimi primar i këtyre dokumenteve është integrimi i komunitetit rom dhe ashkali në Kosovë, si dhe qasja e tyre në shoqëri, përqindje më e madhe e punësimit, arsimim cilësor dhe i nevojshëm, kushte më të mira për jetë, si dhe pjesëmarrja në institucionet shtetërore që do të mundësonte forcimin e rolit të tyre në vendimmarrje.

Prej metodave dhe teknikës së hartimit të këtij plani të veprimit janë shfrytëzuar mënyrat si në vijim:
1. Shënimet janë marrë nga Strategjia dhe Plani i Veprimit të Qeverisë së Kosovës.
2. Diskutime në grupe punuese dhe marrja e informatave nga antarët e grupit.
3. Shënimet janë pranuar nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Shënimet janë marrë nga kërkesat e pjesëtarëve të komunitetit rom.
5. Shënimet janë marrë nga kërkesat e pjesëtarëve të komunitetit ashkali.

6. Konsultimet me sektorin joqeveritar.

Kjo mënyrë e grumbullimit të informatave ka mundësuar që problemet e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali të përfshihen në një dokument të ngjashëm për t'u evituar çfarëdo duplifikimi i aktiviteteve apo kërkesave.

Bashkëpunimi me sektorin joqeveritar ka ndihmuar në caktimin e prioriteteve të veprimit dhe harmonizimit të Planit të veprimit nga niveli qendror me Planin e veprimit komunal.

**Disa fjalë për strukturën jetësore të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.**

Pasi që në Komunën e Vushtrrisë komunitet egjiptian nuk ka pasur as para luftës dhe as tash nuk ka, prej këtyre komuniteteve tjera që jetojnë në Komunën e Vushtrrisë komuniteti rom dhe ashkali janë të shpërndarë në këto vendbanime:

Komuniteti ashkali jeton në qytetin e Vushtrrisë, Bukosh dhe Stanoc i Ulët, ndërsa komuniteti rom gjendet në fshatin Prelluzhë.

Para lufte këto komunitete kanë jetuar në vendbanime si:

Novolan, Vërnicë, Reznik, Maxhunaj, Gllavatin, Samadrexhë. Edhe pse tashmë e sa vite në Komunën e Vushtrrisë është krijuar një klimë e mirë për të gjitha komunitetet, po ashtu edhe për komunitetin rom dhe ashkali ende nuk po ndodh kthimi i këtij komuniteti në vendbanimet ku kanë jetuar deri në vitin 1999.

Aktualaisht në Komunën e Vushtrrisë jetojnë 235 persona të komunitetit rom dhe 140 persona të komunitetit ashkali.

**Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021 i përmbahet Strategjisë dhe Planit të Veprimit Qendror dhe ka katër objektiva strategjike si më poshtë:**

- **Objektivi strategjik 1: Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**
- **Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali**
- **Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore edhe cilësisë së jetës për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**
- **Objektivi strategjik 4: Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për komunitetet rom dhe ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi**

| **Fusha 1: Arsimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 1: Rritja e përshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjestarët e komuniteteve rom dhe ashkali** | **Indikatori /ët për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza 2019** | **Caku 2020** | **Caku 2021** |
| | Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali në edukimin parafillor | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 70% |
| | Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali në edukimin fillor | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 95% |
| | Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali në arsimin e mesëm të ulët | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 90% |
| | Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali në arsimin e mesëm të lartë | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 60% |
| | Shkalla e tranzicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët rom, ashkali | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 50% |
| | Përfshirja e nxënësve të gjinisë femërore në arsim, niveli fillor | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 90% |
| | Përfshirja e nxënësve të gjinisë femërore në arsim, niveli i mesëm i ulët | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 70% |
| | Përfshirja e nxënësve të gjinisë femërore në arsim, niveli i mesëm i lartë | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | 50% |
| | Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor | Të gjithë nxënësit e riatdhesuar | Të gjithë nxënësit e riatdhesuar | Të gjithë nxënësit e riatdhesuar |
| | Ulja e shkallës e braktisjes së shkollimit të obligueshëm | 30% | 40% | 40% |
| | Ulja e shkallës e braktisjes së shkollimit të mesëm të lartë | 30% | 40% | 40% |

| Rezultati 1.1. Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 1.1.1 Stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor | Mbështetja e programeve parashkollore në qendrat mësimore | Mbështetja e programeve parashkollore në qendrat mësimore | Mbështetja e programeve parashkollore në qendrat mësimore | | | Komuna | MASHT, donatorët |
| | | Përkrahja e klasave parafillore në shkollat ku gravitojnë komunitetet rom dhe ashkali | Përkrahja e klasave parafillore në shkollat ku gravitojnë komunitetet rom dhe ashkali | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | | Ndërtimi i kopshteve publike në lokacionet ku jetojnë komunitetet rom dhe ashkali | Ndërtimi i kopshteve publike në lokacionet ku jetojnë komunitetet rom dhe ashkali | | | MASHT | Komuna |
| 1.1.2 Masa stimuluese për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë | Ndarja e bursave për nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali që vijojnë shkollën e mesme të lartë. Në pajtueshmëri me Rregulloren komunale për ndarjen e bursave. Ndarja e bursave për studentët që studiojnë në univerzitetet publike | Ndarja e bursave për nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali që vijojnë shkollën e mesme të lartë. Në pajtueshmëri me Rregulloren komunale për ndarjen e bursave. Ndarja e bursave për studentët që studiojnë në univerzitetet publike | Ndarja e bursave për nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali që vijojnë shkollën e mesme të lartë. Në pajtueshmëri me Rregulloren komunale për ndarjen e bursave. Ndarja e bursave për studentët që studiojnë në univerzitetet publike | 2x400=800 x 3 vite =2400 | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| 1.1.3 Organizimi i kurseve të gjuhës shqipe për nxënësit e komunitetit rom | Përfshirja e nxënësve rom në kurse | Përfshirja e nxënësve rom në kurse | Përfshirja e nxënësve rom në kurse | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| 1.1.4 Komuna në bashkëpunim me donatorët u ofron nxënësve rom dhe ashkali kryerjen e shkollimit të mesëm të lartë në profilet e shkollave profesionale | Përfshirja e pesë (5) pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | Përfshirja e pesë (5) pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | Përfshirja e pesë (5) pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| 1.1.5 Mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve | Hulumtimi i nevojave për arsimimin e të rriturve nga radhët e | | | | Donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | |
| | Organizmi i kurseve të lexim-shkrimit për të rriturit (20 vijues) | Organizmi i kurseve të lexim-shkrimit për të rriturit (20 vijues) | Organizmi i kurseve të lexim-shkrimit për të rriturit (20 vijues) | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | Përfshirja e së paku 5 pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | Përfshirja e së paku 5 pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | Përfshirja e së paku 5 pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e arsimit profesional | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | Njoftimi për mundësitë e arsimimit të të rriturve (materiale promovuese) | Njoftimi për mundësitë e arsimimit të të rriturve (materiale promovuese) | Njoftimi për mundësitë e arsimimit të të rriturve (materiale promovuese) | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| Komuna në bashkpunim me donatorët u ofron komuniteteve kryrjen e shkollimit për të rritur, në profilet e shkollave profesionale | Organizimi i kurseve të gjuhës shqipe për komunitetin rom | Organizimi i kurseve të gjuhës shqipe për komunitetin rom | Organizimi i kurseve të gjuhës shqipe për komunitetin rom | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | |
| | | | **Total:** | **2400 €** | | | |

| **Rezultati 1.2. Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet** | **Pikat e referimit** | | | **Kostoja financiare** | **Burimi i financimit** | **Institucionet** | |
| | **2019** | **2020** | **2021** | | | **Udhëheqja** | **Mbështetja** |
| 1.2.1. Inkurajimi i femrave rome dhe ashkali për parandalimin e braktisjes dhe vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | | DKA, MASHT, Donatorët | Komuna | MASHT, Donatorët |
| 1.2.2 | | Hartimi i udhëzimit administrativ për qendrat mësimore | | | DKA, MASHT, Donatorët | Komuna | MASHT, Donatorët, Organizatat ndërkomb. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ofrimi i mbështetjes financiare për një (1) qendër mësimore në shërbim të komuniteteve rom dhe ashkali | Ofrimi i mbështetjes financiare për një (1) qendër mësimore në shërbim të komuniteteve rom dhe ashkali | Ofrimi i mbështetjes financiare për një (1) qendër mësimore në shërbim të komuniteteve rom dhe ashkali | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| 1.2.3 Ofrimi i mësimit plotësues për nxënësit që ngecin në mësime | Organizimi i mësimit plotësues në shkolla | Organizimi i mësimit plotësues në shkolla | Organizimi i mësimit plotësues në shkolla | | Buxheti i Kosovës | DKA | MASHT, DKA, donatorët |
| 1.2.4 Promovimi i mësimit të gjuhës dhe rrujatja e kulturës rome dhe e askalinjve | Hulumtimi i nevojave për organizimin e mësimit të gjuhës rome | Hulumtimi i nevojave për organizimin e mësimit të gjuhës rome | Hulumtimi i nevojave për organizimin e mësimit të gjuhës rome | | DKA, DKRS, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | | | Punësimi i mësimdhënësve të gjuhës rome (5 ekuivalent me orar të plotë pune) | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | | | | | | | |

**Rezultati 1.3. Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali**

| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 1.3.1 Zhvillimi i programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me edukimin për fëmijërinë e hershme | Hartimi i pakos së programeve vetëdijesuese për prindër lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme (higjiena, shëndeti, parandalimi i martesave të hershme) | Hartimi i pakos së programeve vetëdijesuese për prindër lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme (higjiena, shëndeti, parandalimi i martesave të hershme) | Hartimi i pakos së programeve vetëdijesuese për prindër lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme (higjiena, shëndeti, parandalimi i martesave të hershme) | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| 1.3.2 Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe | Organizimi i fushatave vetëdijesuese | Identifikimi i fëmijëve të paregjistruar | Zbatimi dhe regjistrimi i të gjithë fëmijëve të regjistruar | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat | | | | | | | |
| 1.3.3 Vetëdijesimi i popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali | | Organizimi i fushatës sensibilizuese për publikun e gjerë | Organizimi i fushatës sensibilizuese për publikun e gjerë | | DKA, MASHT, donatorët | Komuna | MASHT, donatorët |
| | | | | | | | |

| **Fusha 2: Punësimi dhe Mirëqenia Sociale** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali** | **Indikatori /ët për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza 2019** | **Caku 2020** | **Caku 2021** |
| | Norma e punësimit | | Tendenca në rritje | Tendenca në rritje |
| | Norma e punësimit të grave | 9% | 12% | 15% |
| | Përfshirja në MATP | | | |
| | Përfshirja e grave në MATP | | | |
| | Përfshirja në punësim në sektorin publik | 2.5% | 3% | 3.5% |
| | Përfshirja e familjeve të varfra në skemat e ndihmës sociale | 20% | 30% | 35% |
| | Përfshirja e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara permanente, në skemën e mbështetjes financiare | 1.5% | 1.5% | 1.5% |
| | Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara permanente në skemën pensionale | 1.5% | 1.5% | 1.5% |
| | Numri i pjesëtarëve të komuniteteve që pranojnë | 41 | 85 | 100 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | shërbime nga QPS-ja | | | | |

| Rezultati 2.1. Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet** | **Pikat e referimit** | | | **Kostoja financiare** | **Burimi i financimit** | **Institucionet** | |
| | **2019** | **2020** | **2021** | | | **Udhëheqja** | **Mbështetja** |
| 2.1.1 Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përfitimi i tyre nga shërbimet/masat e ofruarangaMPMS | Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës të fuqisë punëtore | Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës të fuqisë punëtore | Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës të fuqisë punëtore | | Donatorët | Donatorët | Komuna |
| | Raportimi irregullti të dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga MPMS | Raportimi i rregullti të dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga MPMS | Raportimiirregulltitë dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëvetëkëtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga MPMS | | | MPMS | |
| 2.1.2 Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike dhe ndërmarrje publike | | | Monitorimi i situatës i punësimit në institucione publike në nivel lokal | | | | |
| | Monitorimi i situatës i punësimit në institucione publike në nivel lokal | Monitorimi i situatës i punësimit në institucione publike në nivel lokal | Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve | | Donatorët | OJQ | |
| | Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve | Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve | | | Donatorët | ZP | |
| | Trajnimi i këshilltarëve të punësimit të angazhuar | | | | Donatorët | MPMS | |
| | Hulumtimi i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera | | Zbatimi i kuotave në MATP (përfshirë trajnime profesionale) | | Donatorët | MPMS | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.3 Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali | Zbatimi i kuotave në MATP (përfshirë trajnime profesionale) | Zbatimi i kuotave në MATP (përfshirë trajnime profesionale) | Organizimi i fushatës të informimit me pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali | | MPMS | MPMS<br>ZP | Qeveria e Kosovës |
| | | Organizimi i fushatës të informimit me pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali | Emetimi videove promovuese | | Donatorët | MPMS<br>ZP | OJQ-të<br>Komuna |
| 2.1.4 Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale | | Emetimi i videove promovuese | Takime me qytetarë | | Donatorët | MPMS | |
| 2.1.5 Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali | | Takime me qytetarë | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

| Rezultati 2.2. Përmirësohet pjesëmarrja e familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali në skemat e mbrojtjes dhe në shërbime sociale | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 2.2.1 Vlerësimi i mbështetjes shtesë për përfituesit e ndihmave sociale | Ofrohen ndihma sociale për familje të varfëra të këtyre komuniteteve | Ofrohen ndihma sociale për familjet e varfëra të këtyre komuniteteve | Ofrohen ndihma sociale për familjet e varfëra të këtyre komuniteteve | | Buxheti i Kosovës | MPMS | |
| | Analizohen të dhënat për madhësinë, strukturën dhe kushtet e familjeve përfituese të skemës së ndihmës sociale | Analizohen të dhënat për madhësinë, strukturën dhe kushtet e familjeve përfituese të skemës së ndihmës sociale | Analizohen të dhënat për madhësinë, strukturën dhe kushtet e familjeve përfituese të skemës së ndihmës sociale | | | MPMS | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vizitohen familjet përfituese të ndihmës sociale, të cilat familje nga analiza e QPS-së janë vlerësuar se ndihmat sociale janë skajshmërisht të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat elementare për jetë | Vizitohen familjet përfituese të ndihmës sociale, të cilat familje nga analiza e QPS-së janë vlerësuar se ndihmat sociale janë skajshmërisht të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat elementare për jetë | Vizitohen familjet sociale, të cilat familje nga analiza e QPS-së janë vlerësuar se ndihmat sociale janë skajshmërisht të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat elementare për jetë | | | MPMS | |
| | Hartohet dokumenti me propozime për MPMS-në për mbështetjen shtesë të nevojshme për këto familje | Hartohet dokumenti me propozime për MPMS-në për mbështetjen shtesë të nevojshme për këto familje | Hartohet dokumenti me propozime për MPMS-në për mbështetjen shtesë të nevojshme për këto familje | | | MPMS | |
| 2.2.2 Identifikimi i fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta | Organizohet fushatë informuese | Organizohet fushatë informuese | Organizohet fushatë informuese | | | MPMS | |
| | Takime informative me DKA-në, për të rritur angazhimin e mësimdhënësve në identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta | | Takime informative me DKA-në, për të rritur angazhimin e mësimdhënësve në identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta | | | MPMS | MASHT |
| | Takime informative me përgjegjësit e qendrave të mjekësisë familjare | | Takime informative me përgjegjësit e qendrave të mjekësisë familjare | | | MPMS | MSH |
| | Ofrohet mbështetje financiare për familjet me fëmijë me nevoja të veçanta | Ofrohet mbështetje financiare për familjet me fëmijë me nevoja të veçanta | Ofrohet mbështetje financiare për familjet me fëmijë me nevoja të veçanta | | Buxheti i Kosovës | MPMS | |
| | Ofrohen pensione për persona të moshës 18-65 vjeçare me nevoja të veçanta | Ofrohen pensione për persona të moshës 18-65 vjeçare me nevoja të veçanta | Ofrohen pensione për persona të moshës 18-65 vjeçare me nevoja të veçanta | | Buxheti i Kosovës | MPMS | |
| 2.2.3 Fushata informative për skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale | Organizohet një fushatë informuese | Organizohet një fushatë informuese | Organizohet një fushatë informuese | | Donatorët | MPMS | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.5 Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për përmirësimine shërbimeve sociale | Vlerësimi i nevojave për trajnimin e punëtorëve të QPS-ve | Vlerësimi i nevojave për trajnimin e punëtorëve të QPS-ve | | | | MPMS | |
| | Ofrohen trajnime për punëtorë të QPS-ve | Ofrohen trajnime për punëtorë të QPS-ve | | | Donatorët | MPMS | |
| | | | | | | | |

| Fusha 3: Shëndetësia | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore edhe cilësisë së jetës për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali** | **Indikatori /ët për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza 2019** | **Caku 2020** | **Caku 2021** |
| | Jetëgjatësia e pjesëtarëve të komuniteteve | //// | ///// | ///// |
| | Përqindja e lindjeve jashtëspitalore - në shtëpi | 0% | 0% | 0% |
| | Shkalla e kënaqshmërisë në qasjen në shërbime publike | 80% | 90% | 95% |
| | Shfrytëzueshmëria e shërbimeve shëndetësore publike nga pjesëtarët e komuniteteve | 71.2% | 80% | 100% |
| | Imunizimi i plotë | 30.2% | 50% | 60% |
| | Lindjet në moshën e hershme | 5% | 3% | 2% |
| | Fëmijët me diarre | ////// | ///// | ////// |
| | Fëmijët me simptoma AR | ///// | ////// | ///// |

| Rezultati 3.1. Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet** | **Pikat e referimit** | | | **Kostoja financiare** | **Burimi i financimit** | **Institucionet** | |
| | **2019** | **2020** | **2021** | | | **Udhëheqja** | **Mbështetja** |
| 3.1.1 Zhvillimi i aktiviteteve për skreningun e kancerit të gjirit | Ekzaminimet me mamograf | Ekzaminimet me mamograf | Ekzaminimet me mamograf | | | MPMS, DSH | Komuna |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.2 Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë, si dhe grupe të tjera të ndjeshme | Realizimii vizitave shtëpiakepërmes ekipeve mobile me profesionistë | Realizimii vizitave shtëpiakepërmes ekipeve mobile me profesionistë | Realizimii vizitaveshtëpiake përmes ekipeve mobile me profesionistë | | | DSH | Komuna |
| 3.1.3 Aktivitetet tjera që arrijnë tek popullata vulnerabile | Ekzaminimettjera shëndetësoretë subvencionuarapër popullatën e rrezikuar | Ekzaminimettjera shëndetësoretë subvencionuarapër popullatën e rrezikuar | Ekzaminimettjera shëndetësoretë subvencionuarapër popullatën e rrezikuar | | | MSH | Komuna, OJQ-të |
| | Program terreni nga OJQ-të | Program terreni nga OJQ-të | Program terreni nga OJQ-të | | Donatorët | MSH | DSH |
| 3.1.4 Masat institucionale që përmirësojnë qasjen në shërbime shëndetësore | Angazhimi i stafit adekuat në punë me komunitete | Angazhimi i stafit adekuat në punë me komunitete | Angazhimi i stafit adekuatnë punë me komunitete | | | MSH | DSH |
| 3.1.5 Monitorimi i vazhdueshëm i qasjes | Monitorimi nga autoritetet lokale | Monitorimi nga autoritetet lokale | Monitorimi nga autoritetet lokale | | Buxheti komunal | MSH | DSH |
| | Monitorimi nga organizatat e shoqërisë civile | Monitorimi nga organizatat e shoqërisë civile | Monitorimi nga organizatat e shoqërisë civile | | Donatorët | MSH | DSH, OJQ-të |
| | | | | | | | |

| Rezultati 3.2 Përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 3.2.1 Fushatat për imunizim | Përgatitja e materialit promovues | | | | Buzheti i Kosovës | MSH | DSH, OJQ-të |
| | | Organizimi i fushatave | Organizimi i fushatave | | | MSH | DSH, IKSHPK, OJQ-të |
| 3.2.2 Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar | Përgatitja e materialit promovues | | | | Buxheti i Kosovës | MSh | DSH, IKSHPK, OJQ-të |
| | | Organizimi i aktiviteteve edukative | Organizimi i aktiviteteve edukative | | Buxheti i Kosovës | MSH | DSH, IKSHPK, OJQ-të |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe shëndet riprodhues | | | | | | | |
| 3.2.3 Edukimi për rëndësinë e kushteve higjieno-sanitare | Përgatitja e materialit promovues | | | | Buxheti i Kosovës | MSH | DSH, IKSHPK, OJQ-të |
| 3.2.4 Avancimi i kapaciteteve preventive të stafit në kujdesin parësor | Trajnime të stafit | Trajnime të stafit | Trajnime të stafit | | | MSH | DSH, donatorët |
| | | | | | | | |

| Rezultati 3.3. Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 3.3.1 Pajisja me kontejnerë familjarë për mbeturina | Blerja e kontejnerëve, mbledhja e mbeturinave | Blerja e kontejnerëve, mbledhja e mbeturinave | Blerja e kontejnerëve, mbledhja e mbeturinave | | Buxheti i Kosovës | MSH | MMPH, komuna, OJQ-të |
| | | | | | | | |

| Fusha 4: Banimi | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 4: Sigurimii banimittë qëndrueshëmpërkomunitetet rom dhe ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi** | **Indikatori/ët për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza 2019** | **Caku 2020** | **Caku 2021** |
| | Numri i familjeve të evidentuara në bazën e të dhënave që kanë pronë private, por jo edhe kushte të përshtatshme banimi | Përpilimi i bazës të të dhënave | Zbatimi | Zbatimi |
| | Numri i familjeve që e kanë të rregulluar statusin e pronës në të cilën jetojnë | 0000 | Regjistimi | Rigjistrimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Vënia në dispozicion e pronës komunale sipas nevojës për ndërtim kolektiv për familjet sociale | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave |
| | Ofrimi i lehtësirave administrative (leje ndërtimore) për ndërtimin e objekteve të banimit në parcelat, pronarët e të cilave janë pjesëtarë të komuniteteve | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave |
| | Ofrimi i ndihmës për ndërtim/renovim të shtëpive, pronarët e të cilave janë pjestarë të komuniteteve | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave | Sipas kërkesave |

| **Rezultati 4.1. Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet** | **Pikat e referimit** | | | **Kostoja financiare** | **Burimi i financimit** | **Institucionet** | |
| | **2019** | **2020** | **2021** | | | **Udhëheqja** | **Mbështetja** |
| 4.1.1 Identifikimi i nevojave në infrastrukturë në vendbanimet e komuniteteve | Identifikimi i familjeve që nuk kanë kushte të përshtatshme për banim | Intervenim sipas nevojes | Intervenim sipas nevojes | | Komuna, qeveria, donatorët | Komuna | |
| | Regjistrimi i nevojave të komuniteteve | Regjistrimi i nevojave të komuniteteve | | | | Komuna | |
| 4.1.2 Caktimi i prioriteteve për familjet në nevojë për përfshirjen në programin e banimit social | Hartimi i listave prioritare për banim social (të përfshihet në listat e përgjithshme) | Hartimi i listave prioritare për banim social | Hartimi i listave prioritare për banim social | | | Komuna | |
| | | | | | | | |

**Rezultati 4.2. Është shtuar ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit**

| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 4.2.1 Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për përfshirje në çështjen e banimit | Zgjidhja e lokacioneve më të frekuentuara për organizimin e fushatës senzibilizuese | | | | | MMPH | |
| | Zhvillimi dhe shtypja e materialeve të fushatës | | | | Donatorët | MMPH | |
| | Trajnimet në komunitet për të drejtat pronësore në Kosovë | Trajnimet në komunitet për të drejtat pronësore në Kosovë | Trajnimet në komunitet për të drejtat pronësore në Kosovë | | Donatorët | MMPH | |
| | Sensibilizimi i faktorëve vendimmarrës për të drejtat pronësore të komuniteteve rom dhe ashkali | | | | Donatorët | MMPH | |
| 4.2.2 Mbështetja e komuniteteve rom dhe ashkali për pajisje me dokumentacion përkatës pronësor apo një të drejtë tjetër të tokës në të cilën mund të ndërtohet | | Projekte për të drejtat pronësore të komuniteteverom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë | Projekte për të drejtat pronësore të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë | | Donatorët | MMPH | |
| | | | | | | | |

| Rezultati 4.3. Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet | Pikat e referimit | | | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Institucionet | |
| | 2019 | 2020 | 2021 | | | Udhëheqja | Mbështetja |
| 4.3.1 . Hartimi i projekteve prioritare për renovim, rindërtim apo ndërtim të shtëpisë në parcelat vetanake | Hulumtimi i donatorëve për renovim | Zbatimi i projekteve për renovim | Zbatimi i projekteve për renovim | | Donatorët, Buxheti i Kosovës | MMPH, MKK | Komuna |
| | Projekte për renovim të shtëpive në parcelën vetanake | Projektepërrenovimtë shtëpivenëparcelën vetanake | Projekte për renovim të shtëpive në parcelën vetanake | | | MKK | |
| 4.3.3 Hartimi i projekteve prioritare për banim social | Hartimi i programeve trevjeçare për banim nga ana e komunave | | | | | Komuna | |
| | Ndarja e parcelave në pronën komunale për banim social | Ndarja e parcelave në pronën komunale për banim social | Ndarja e parcelave në pronën komunale për banim social | | | Komuna | |
| | Aprovimi i listave të përfituesve të banimit social | Aprovimi i listave të përfituesve të banimit social | Aprovimi i listave të përfituesve të banimit social | | | Komuna | |
| | | | | | | | |

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

212/19
-1-
27.06.2019

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, pika "d" në lidhje me nenin 17, pika "s" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 qershor 2019,** mori këtë:

**VENDIM**
**PËR EMËRTIMIN E QENDRËS RINORE**

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë vendosi që Qendra Rinore e Komunës së Vushtrrisë të emërtohet me emrin e qiftit "Naxhije dhe Fahri Buçinca".

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**